



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri



*Konferencë Shkencore Ndërkombëtare me rastin e 100-vjetorit
të Miratimit të Rregullores së Parë të Kuvendit të Shqipërisë*

**Legjitimimi me procedurë: Roli i parlamenteve
në vendimmarrjen publike në të shkuarën dhe të tashmen**

TIRANË, 27 mars 2020

Organizatorët:

Prezenca e OSBE-së në Shqipëri
Kuvendi i Shqipërisë
Albanian University, Tiranë
Universiteti i Tiranës

Në bashkëpunim me:

Seksionin e Arkivave dhe Arkivistëve të Parlamenteve dhe Partive Politike në Këshillin Ndërkombëtar të Arkivave (SPP/ICA)
Komisionin Ndërkombëtar për Historinë e Institucioneve Përfaqësuese dhe Parlamentare (ICHRPI)

Fokusi i konferencës

Fokusi i kësaj konference do të jetë sistemi parlamentar shqiptar në një qasje krahasuese brenda bashkësisë ndërkombëtare të studiuesve parlamentarë, zhvillimi dhe kujtesa, procedurat, përfshirë funksionet dhe detyrat kryesore. Reflektimet për rolin e grave dhe transparenca përmes përfshirjes së shoqërisë civile dhe akademisë do të jenë, gjithashtu, pjesë e punës së kryer nga studiues parlamentarë, ekspertë dhe praktikues parlamentarë të cilët do të bashkohen në diskutime dhe reflektime për atë që ka ndodhur, përfshirë planifikimin më të mirë për të ardhmen e parlamentarizmin shqiptar.

Informacion i përgjithshëm

Kur Parlamenti Shqiptar, në atë kohë i quajtur Këshilli Kombëtar, u krijua në vitin 1920, një nga aktet e tij të para ishte miratimi i një sërë rregullash, duke pranuar kështu që procedura parlamentare dallon nga proceset e tjera vendimmarrëse duke ndjekur një standard rregullator të nivelit të lartë. Vetëm nëse zbatohen rregullat zyrtare, rezultati i procesit legjislativ mund dhe do të fitojë legjitimitetin që i nevojitet, për të fituar pranimin e gjerë të publikut të nevojshëm për t'i

Funded by



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri



bërë ligjet një instrument efektiv për të qeverisur sjelljen institucionale dhe individuale dhe ndërveprimin në sfera publike. Me rastin e 100-vjetorit të këtij hapi të rëndësishëm në historinë e Kuvendit të Shqipërisë, një ekspozitë do të dokumentojë zhvillimin e rregullore së këtij institucioni, nga varianti i parë i vitit 1920 deri në ndryshimet më të fundit të korrikut 2019. Hapja e kësaj ekspozite ofron mundësinë për të diskutuar, brenda kuadrit të një konference ndërkombëtare, aspekte të ndryshme të rolit të Parlamentit në vendimmarrjen publike në një perspektivë ndërdisiplinore.

Projektprogrami:

26 mars 2020

Prezantimi: Hapja e ekspozitës mbi historinë e rregulloreve të Kuvendit të Shqipërisë me titull **“Rregulloret e Parlamentit Shqiptar në 100 vjet”**

27 mars 2020

- Sesioni I: Kuvendi i Shqipërisë - zhvillimi dhe kujtesa e tij
- Sesioni II: Vendimmarrja parlamentare - Procedura parlamentare
- Sesioni III: Funkcioni përfaqësues i Kuvendit - Gratë në Parlament
- Sesioni IV: Transparenca dhe Kuvendi - Parlamenti dhe shoqëria civile

INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Gjuhët e konferencës: shqip, anglisht

Vendndodhja e konferencës: *(pritet konfirmimi)*

Udhëzime për abstraktin:

Çdo abstrakt duhet të dërgohet elektronikisht, në gjuhën shqipe dhe angleze, brenda afateve të përcaktuara. Në fillim të tij, të vendoset tema e studimit, më pas plotësohen në tekst të dhënat personale: titulli ose grada dhe emri i aplikuesit, institucioni dhe adresa e kontaktit. Abstrakti nuk duhet të ketë më shumë se 300 fjalë dhe duhet të përmbajë (1) fokusin e punimit (2) metodat e përdorura (3) rezultatet/gjetjet (4) konkluzionet dhe rekomandimet kryesore sipas tematikës së konferencës, si edhe 4-5 fjalë kyçe.

Afatet kohore të propozuara si më poshtë:

- 22 shkurt 2020-** afati kohor për dërgimin e temave dhe abstrakteve
- 02 mars 2020** - Vendimi / shpallja përfundimtare e abstrakteve të pranuar
- 15 mars 2020** - Dërgimi i punimit të plotë
- 20 mars 2020** – Programi i detajuar i konferencës, konfirmimi i folësve
- 26 - 27 mars në Tiranë** - Prezantimi i Ekspozitës dhe Konferenca

Adresa e kontaktit për dërgimin e abstraktit dhe artikullit:

Prezenca e OSBE-së: asu-al@osce.org

Funded by



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC